

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6534
E shtunë, 12 shkurt 2022
çmimi 0.40 €

Dorëzohen 80 kallëzime penale për krime lufte në Gjakovë



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

BUNDESRATI GJERMAN KA VOTUAR NJOHJEN E NDËRSJELLË TË PATENTËSHOFERËVE NË MES TË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË DHE REPUBLIKËS SË KOSOVËS

FAQE 4-5

GJERMANIA NJEH PATENTËSHOFERËT E KOSOVËS



Këshilli Federal (Bundesrati) i Gjermanisë ka votuar për njohjen e patentëshoferëve të Kosovës dhe të Shqipërisë. Për marrëveshjen e cila do të hyjë në fuqi brenda dy jave kanë votuar të gjithë anëtarët e këtij këshilli. Politikanët vendorë nuk kanë hezitur t'i marrin meritat për këtë marrëveshje. Presidenca dhe qeveria kanë bërë me dije se kanë punuar shumë që kjo njohje të ndodhë, ndërsa zyrtarët e qeverive të kaluara kanë thënë se për këtë çështje është punuar gjatë

AKTUALE



KRASNIQI TAKON BASHËN: BASHKËPUNIMI KOSOVË - SHOQPËRI MBETET PRIORITYET I PRIORITYEVE F. 3

PSD-ja PARALAJMËRON ORGANIZIMIN E NJË PROTESTE TJETËR KUNDËR SHITJES TË RRYMËS F. 3

HAXHIU, PROKURORËVE: HETIMET PROFESIONALE KULMOJNË ME AKTGJYKIME DËNUESE F. 3


EKONOMI



RASTI I 2.1 MILIONË EUROVE, LABINOT GRUDA E PRANON FAJËSINË F. 8

KAPEN CIGARE TË KONTRABANDUARA F. 8

SPORT



DRITA ME FITORE SYNON TA NISË SEZONIN PRANVEROR F. 10

Stoltenbergu: Ka rrezik për një konflikt të armatosur në Evropë

FAQE 2



SHBA-ja I DHURON KOSOVËS MBI 500 000 DOZA TË 'PFIZER'-it

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni zhblokton një pjesë të rezervave afgane

WASHINGTON, 11 SHKURT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, ka nënshkruar një urdhër ekzekutiv për të zhblokuar rreth 7 miliardë dollarë të rezervave afgane, që ishin ngrirë pasi talebanët morën kontrollin e shtetit gushtin e vitit të kaluar.

ShBA-ja do të krijojë një fond në muajt në vazhdim, që do ta administrojë gjysmën e 7 miliardë dollarëve, thanë zyrtarët e Shtëpisë së Bardhë. Pjesa e mbetur prej 3.5 miliardë dollarëve do të qëndrojë në ShBA dhe do të përdoret për ta financuar dëmshpërblimin e viktimave amerikane të terrorizmit, përfshirë edhe për pretendimet ndaj talebanëve nga familjet e viktimave të sulmeve të 11 shtatorit të vitit

2001 në ShBA.

Në urdhrin ekzekutiv të Bidenit theksohet "kriza e madhe humanitare në Afganistan - përfshirë edhe nevoja urgjente për siguri të ushqimit të popullit të Afganistanit, mbështetjen jetësore, të ujit, të shëndetësisë, higjienës, strehimit dhe mbështetjen e vendbanimeve, mbështetjen e lidhur me Covid-19 dhe nevoja të tjera bazike njerëzore".

Bideni ka theksuar se rezervat e Bankës Qendrore të Afganistanit, që mbahen në institucionet financiare amerikane, do të përdoren për ta "adresuar emergjencën kombëtare dhe mirëqenien e popullit të Afganistanit".

Urdhri i Bidenit kërkon që fondet e Bankës Qendrore afgane të dërgohen në një

llogari të Rezervës Federale të Nju-Jorkut. Zyrtarët amerikanë thonë se shumica e aseteve të ngrira afgane në ShBA do të përdoren për ndihmë.

Shtëpia e Bardhë është përballur me presion për t'i zhblokuar fondet për t'i ndihmuar afganët, të cilët po përballen me krizë ekonomike dhe financiare, që po kërcënon mbi gjysmë e popullsisë me uri. Gjatë kësaj jave zyrtarët talebanë po mbajnë bisedime në Gjenevë me organizatat ndërkombëtare, për të kërkuar qasje në ndihmën humanitare, që është ndaluar, pasi qeveria de facto në Kabul nuk është njohur nga asnjë qeveri në botë për shkak të shqetësimeve për të drejtat dhe liritë e njeriut.

Afganistani ka mbi 9 miliardë dollarë rezerva, përfshirë edhe



mbi 7 miliardë dollarë rezerva që mbahen në ShBA. Pjesa tjetër e rezervave gjenden në

Gjermani, Emiratat e Bashkuara Arabe, Zvicër dhe Katar.

Macroni ka refuzuar testin rus për koronavirus

PARIS, 11 SHKURT - Presidenti francez Emmanuel Macron ka refuzuar testin rus për koronavirus para takimit që ka zhvilluar me presidentin rus Vladimir Putin këtë javë, ka konfirmuar Kremlini.

Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, ka thënë se Rusia e kupton pozicionin francez dhe kjo gjë nuk ka ndikuar në bisedime. Testimi ka kërkuar protokolle shëndetësore që kanë qenë të papranueshme dhe ato nuk janë përshtatur me orarin e liderit të Francës, kanë thënë burime franceze për transmetuesin britanik, BBC.

Ky njoftim vjen pas raportimeve se Macroni ka refuzuar të kryejë testet PCR pas shqetësimeve se rusët mund ta kenë mostra të

ADN-së së tij.

Liderët janë parë nëpër fotografi duke mbajtur takime në distancë fizike.

Ata nuk kanë shtrënguar duart dhe janë ulur në tavolinën katër metra të gjatë.

Disa vëzhgues kanë pyetur nëse Putini është duke e përdorur atë situatë për të dërguar mesazh diplomatik.

Mirëpo një burim diplomatik francez ka thënë për agjencinë e lajmeve "Reuters" se Macronit i është thënë të vendosë nëse do ta pranojë testin rus PCR për të qenë më afër Putinit, në të kundërtën duhet t'i zbatojë rregullat e distancimit fizik. "Ne e kemi ditur shumë mirë se ajo ka nënkuptuar se nuk do të ketë shtrëngim duarsh dhe tavolinë



të gjatë. Mirëpo ne nuk mund të pranonim që ata të kenë në duar ADN-në e presidentit", ka thënë një burim për "Reuters".

Ky burim nuk ka dhënë hollësi sesi mund t'i shfrytëzojnë shërbimet ruse të inteligjencës

mostrat e ADN-së së Macronit. Përgjatë takimit, Macroni dhe Putini kanë biseduar pesë orë për tensionet rreth Ukrainës. Shtetet e Perëndimit kanë thënë se Rusia mund ta pushtojë Ukrainën, mirëpo Rusia mohon se ka plane

të tilla, ndonëse ka mbledhur 100 000 trupa në kufirin afër Ukrainës. Departamenti Amerikan i Shtetit u ka bërë thirrje të gjithë shtetasve amerikanë që të largohen menjëherë nga Ukraina.

Stoltenbergu: Ka rrezik për një konflikt të armatosur në Evropë

BRUKSEL, 11 SHKURT - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, të premten ka vizituar një bazë ajrore ushtarake në Rumani, që është nikoqire e afro 1 000 trupave amerikane, që janë dislokuar në këtë shtet si pjesë e përpjekjeve të aleancës për ta forcuar krahun lindor, pas rritjes së tensioneve midis Rusisë dhe Ukrainës.

Stoltenbergu, që u takua në bazën ajrore Mihail Kogalniceanu, me presidentin rumun Klaus Iohannis dhe

zyrtarë të tjerë të lartë, tha se "ka rrezik për një konflikt të armatosur në Evropë". "Ne nuk kemi siguri lidhur me atë që do të ndodhë. Prandaj ne i bëjmë thirrje Rusisë që ta shtensionojë situatën. Ne jemi vigjilentë dhe të përgatitur dhe kjo është arsyeja që prezenca e trupave të NATO-s në Rumani është kaq e rëndësishme", ka thënë Stoltenberg për gazetarët.

Vizita e Stoltenbergut në Rumani po ndodh në të njëjtën ditë kur karvanët e ushtrisë amerikane,

me pajisje ushtarake erdhën në këtë bazë rumune. Shtetet e Bashkuara po rivendosin 1,000 trupa nga Gjermani në Rumani, pasi zyrtarët amerikanë kanë frikë se Rusia shumë shpejt do ta pushtojë Ukrainën. Trupa të NATO-s po ashtu janë dislokuar në Poloni.

Rusia ka grumbulluar mbi 100 000 trupa përgjatë kufirit me Ukrainën dhe ka kryer një sërë manovrash ushtarake në rajon. Por, Moska thotë se nuk ka plane që ta pushtojë Ukrainën.



ShBA-ja i dhuron Kosovës mbi 500 000 doza të 'Pfizer'-it

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 SHKURT - Kosova ka pranuar 515 970 doza të vaksinës "Pfizer", të cilat janë siguruar nga presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden. Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka falënderuar ShBA-në për këtë donacion, që në Kosovë erdhi përmes mekanizmit "Covax", që udhëhiqet nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. "Dita e sotme është një moment i rëndësishëm për të rikujtuar se përkundër humbjeve dhe vuajtjeve të mëdha që pandemia Covid-19 u ka shkaktuar popujve anembanë botës, kanë zbuluar edhe vlerat më të mëdha që kanë popujt, siç janë solidariteti dhe mbështetja në njëri-tjetrin, duke krijuar një aleancë të fuqishme njerëzore. Një aleancë e tillë është edhe kjo e organizuar përmes mekanizmit Covax, që e ka bërë luftën tonë

kundër Covid-19 definitivisht më të lehtë", ka thënë Latifi në ceremoninë për pranimin e vaksinave në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike.

Latifi ka thënë se vetëm përmes vaksinimit Kosova mund t'i kthehet plotësisht normalitetit, andaj u bëri thirrje qytetarëve që të imunizohen kundër koronavirusit.

Ky nuk është donacioni i parë i vaksinave që ShBA-ja i ka dhuruar Kosovës. Vitin e kaluar Uashingtoni dërgoi në Prishtinë një donacion mbi 500 000 dozash të kompanisë farmaceutike amerikane "Pfizer" përmes mekanizmit "Covax".

Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeff Hovenier, ka theksuar se ShBA-ja është donatorja më e madhe në Kosovë, pasi deri më tani ka dhuruar mbi 1 milion doza të vaksinës. "Me donacionin e ri të ShBA-së, do të jetë e mjaftueshme për të vaksinuar 30 për qind të

popullsisë së përgjithshme të Kosovës me të dyja dozat", është shprehur Hovenier.

Ai ka thënë se Uashingtoni, po ashtu, ka mbështetur Kosovën me pajisje mjekësore gjatë pandemisë. "ShBA-ja vazhdon të jetë e gatshme dhe e përkushtuar për të punuar me Qeverinë e Kosovës në luftën kundër Covid-19. Që të gjithë jemi së bashku në këtë luftë, ne jemi partneri juaj", ka thënë ambasadori Hovenier.

Kosova ka nisur fushatën e imunizimit kundër koronavirusit në fund të marsit të vitit të kaluar, fillimisht me vakcina të dhuruara nga "Covax"-i, por edhe nga shtete të tjera. Më pas autoritetet arritën edhe një marrëveshje me kompaninë "Pfizer" për blerjen e 1.2 milion dozave të vaksinës. Deri më tani në Kosovë me dy doza të vaksinës janë imunizuar 45.11 për qind e popullatës. Në vend ka nisur edhe dhënia e dozave përforcuese dhe atyre të treta.

Dy viktimat dhe 770 raste të reja me Covid-19

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në Kosovë janë regjistruar dy viktimat dhe 770 raste të reja me Covid-19. Rastet e reja dolën pas testimit të 4 285 mostrave, që i bie se 17.93 për qind e të testuarve kanë rezultuar pozitivë në sëmundjen Covid-19. Sipas raportit të Ministrisë së Shëndetësisë, që iu referohet të dhënave të 24 orëve paraprake, edhe 1 589 pacientë janë shëruar nga koronavirusi. Ndërkaq, raste aktive me Covid-19 janë 16 028. Sa i përket vaksinimit, në 24 orët paraprake janë administruar edhe 1 319 doza

të vaksinës kundër koronavirusit. Në Kosovë deri më tani me dy doza të vaksinave janë imunizuar 45.11 për qind e popullatës. Ndryshe, më 11 shkurt, Kosova pranoi mbi 500 000 doza të vaksinës së "Pfizer"-it. Ky kontingjent, donacion i Shteteve të Bashkuara, erdhi në Kosovë përmes mekanizmit "Covax" të udhëhequr nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Ministri i Shëndetësisë së Kosovës, Rifat Latifi, ka thënë se vetëm përmes vaksinimit shteti mund t'i kthehet plotësisht normalitetit.



Haxhiu, prokurorëve: Hetimet profesionale kulmojnë me aktgjykime dënuese

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se konferenca vjetore e prokurorëve është një ditë shumë e rëndësishme për sistemin prokurorial. "Të nderuar prokurorë, jam e vetëdijshme që keni një punë të rëndë dhe sfiduese, ndjekja e një veprë është një barrë e rëndë, mirëpo siguria e qytetarëve varet edhe nga

puna juaj, viktimat e krimit kërkojnë mbrojtje dhe drejtësi, prandaj edhe kemi plotësisht të drejtë t'ju kërkojmë që t'i shërbeni ligjit dhe t'i qaseni drejtësisë me përpulsi", ka thënë Haxhiu në konferencën vjetore të prokurorëve. Ajo ka thënë se institucionet e Kosovës e kanë për obligim që ta sigurojnë punën e prokurorëve pa asnjë pengesë. "E kemi obligim që t'ju

ofrojmë mbrojtje kur rrezikohet siguria juaj personale për shkak të kryerjes së funksioneve prokuroriale", është shprehur Haxhiu. Ministria Haxhiu ka theksuar se hetimet profesionale e të mbështetura në ligj, që kulmojnë me aktgjykime dënuese e ndëshkim për kryesit e veprës penale, është ajo që secili qytetar pret nga prokurorët.





BUNDESRATI GJERMAN KA VOTUAR NJOHJEN E NDËRSJELLË TË PATENTËSHOFERËVE NË MES TË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË DHE REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Gjermania njeh patentëshoferët e Kosovës

Këshilli Federal (Bundsrati) i Gjermanisë ka votuar për njohjen e patentëshoferëve të Kosovës dhe të Shqipërisë. Për marrëveshjen e cila do të hyjë në fuqi brenda dy jave kanë votuar të gjithë anëtarët e këtij këshilli. Politikanët vendorë nuk kanë hezitur t'i marrin meritat për këtë marrëveshje. Presidenca dhe qeveria kanë bërë me dije se kanë punuar shumë që kjo njohje të ndodhë, ndërsa zyrtarët e qeverive të kaluara kanë thënë se për këtë çështje është punuar gjatë

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 11 SHKURT - Pas propozimit të qeverisë federale, Këshilli Federal i Gjermanisë ka vendosur t'i njohë patentëshoferët e Kosovës dhe të Shqipërisë. Për marrëveshjen kanë votuar 69 anëtarët e Bundesratit, që përbëjnë tërësinë e qeverive federale. Marrëveshja e cila do t'u mundësojë qytetarëve të Kosovës dhe të Shqipërisë konvertimin e patentave pa provim shtesë pritet të hyjë në fuqi brenda dy javësh.

Kryetar i Konferencës së Ministrave të Transportit, Winfried Herrmann, ministër i Transporteve të Landit Baden Württemberg, ka thënë se shumë imigrantë nga Kosova

punojnë në zanate që kanë nevojë për një patentë. "Për fat të mirë ua hoqëm edhe këtë pengesë!", ka thënë ai. Marrëveshja e re vlen vetëm për personat që kanë një vendbanim të rregullt në Gjermani dhe që e kanë bërë patentën përpara se të shkonin në Gjermani.

Kush ka shkuar në Gjermani pa patentë shofer dhe ka vendbanimin e rregullt në Gjermani, nuk mund të shkojë për pushime në Kosovë ose Shqipëri dhe ta marrë patentën.

Kosova mirëpret njohjen e patentëshoferëve

Institucionet e Kosovës e kanë mirëpritur vendimin e Bundesratit për t'i njohur

patentëshoferët. Pas votimit, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se në takimet me zyrtarët e lartë gjermanë kjo ka qenë ndër çështjet kryesore të diskutimit. "Gjatë vizitës zyrtare në Gjermani, në takimet me presidentin Steinmeier, si dhe në takimet me ish-ministrin e Punëve të Jashtme, z. Maas, fillimisht në Prishtinë më 22 prill të vitit të kaluar, e pastaj dhe gjatë qëndrimit tim në Berlin, kjo ishte një prej diskutimeve kryesore, e cila reflektonte edhe një prej brengave kryesore të mërgatës sonë atje. Jashtëzakonisht mirënjohëse për bashkëpunimin e institucioneve gjermane për trajtimin e kësaj kërkesë të kamotshme", ka shkruar ajo në "Facebook".

Ajo ka shtuar se do të vazhdohet bashkëpunimi me shtetin gjerman. "Ky hap sot konfirmon besueshmërinë e institucioneve gjermane në procedurat dhe punën e institucioneve tona, e rrjedhimisht kontribuon në avancimin tutje të raporteve tona tashmë të shkëlqyeshme bilaterale. Do ta vazhdojmë punën në bashkëpunim me institucionet e tjera në vend për t'u siguruar që ky shembull të ndiqet edhe nga shtetet e tjera të BE-së", ka shkruar Osmani. Ky lajm është mirëpritur edhe nga kryeministri Albin Kurti. "Lajm i mrekullueshëm për qytetarët tanë në Gjermani. Sot Këshilli Federal i Gjermanisë votoi pro njohjes së patentë shoferëve kosovarë, duke shfaqur përkrahje të plotë në autoritetet kompetente kosovare. Herzlichen Dank (Faleminderit shumë!)", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Twitter". Kurse ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë se kjo ka ndodhur falë punës së qeverisë Kurti. "Ky sukses është rezultat i një

angazhimi të madh të ekipeve tona, të cilët gjej rastin t'i falënderoj për punën e tyre të palodhshme si dhe kërkesa më e shpeshtë e qytetarëve tanë kudo nga Gjermania. Që nga marrja e detyrës kemi punuar intensivisht që ky proces të përfundojë suksesshëm dhe sa më parë. Marrëveshja, sipas legjislacionit në Republikën Federale të Gjermanisë, ka marrë aprovimin e të gjitha landeve dhe patentëshoferët do të njihen në tërë Gjermaninë", ka shkruar Sveçla në profilin e vet në "Facebook". Ndërsa ish-kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se për këtë çështje është punuar edhe gjatë qeverisjes së tij. "Janë mbajtur shumë diskutime me palën gjermane, janë shkëmbyer vizita dhe të dhëna zyrtare për vite me radhë. Partneriteti Kosovë-Gjermani është i përhershëm. Pjesa më e madhe e qytetarëve të Kosovës që kanë emigruar për dekada me radhë kanë gjetur strehim dhe punë në Gjermani falë mikpritjes së shtetit dhe popullit gjerman. Shumë familje në Kosovë e kanë

Kurti në Ditën Ndërkombëtare të Vajzave dhe Grave në Shkencë: Duhet ta mbyllim hendekun ekzistues gjinor

Prishtinë, 11 shkurt (ER) - "Për Qeverinë e Kosovës, zhvillimi i gjithëmbarshtëm nuk mund të paramendohet pa arsim cilësor, pa zhvillim të kapitalit njerëzor, e qasje të barabartë në mundësitë për zhvillim", ka thënë Kurti në Ditën Ndërkombëtare të Vajzave dhe Grave në Shkencë.

Në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët "Naim Frashëri", ku edhe vetë ishte nxënës për tetë vjet,

kryeministri ka vizituar Klubin e Kodimit të kësaj shkolle. Nga vajzat pjesëmarrëse në klubet e kodimit u paraqitën projektet inovative të zhvilluara nga nxënëset e shtatë shkollave të mesme të ulëta nga e gjithë Kosova.

Kryeministri Kurti ka theksuar se përmes punës së përbashkët duhet ta mbyllim hendekun ekzistues gjinor, të sigurohet që pjesëmarrja e grave në fushën e shkencës,

teknologjisë e inovacionit, të mos jetë përjashtim, por normë. "Së bashku do të punojmë për t'i avancuar vajzat dhe gratë në shkencë, teknologji dhe inovacion, për arritjen e barazisë gjinore", ka deklaruar Kurti.

Ai ka bërë me dije se nëpërmjet "Sfidës së shkencës" do të synohet qysh herët të nxënësit e nivelit parauniversitar të frymëzohet me ndërveprim me konceptet e

shkencës, duke nxitur garë ndërmjet ekepeve dhe shkollave. "Me Rrjetin e Grave në STEM do të ofrojmë ombrellë afatgjatë të organizimit dhe forcimit të grave dhe vajzave në këto fusha shkencore", ka deklaruar kryeministri, duke shtuar se përtej shënimit simbolik të 11 shkurtit, nga viti i ardhshëm do të organizohet konferencë vjetore për gratë në shkencë për t'i promovuar

arritjet shkencore të grave dhe vajzave.

Kryeministri u bëri thirrje vajzave që do t'i nisnin studimet sivjet, që t'i konsiderojnë studimet në fushat e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës - STEM. Për ta ndihmuar avancimin e vajzave në shkencë, këtë vit akademik Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndarë 1 365 bursa në vlerë 1 000 euro për vajzat në STEM.



PSD-ja paralajmëron organizimin e një proteste tjetër kundër shtrenjtimit të rrymës



PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Pas takimit me disa nga partitë opozitare, Partia Socialdemokrate (PSD) ka paralajmëruar organizimin e një proteste tjetër kundër shtrenjtimit të rrymës. Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, para medieve ka thënë se ka pajtim që duhet të ketë protestë qytetare të përbashkët. "Jemi pajtuar për bashkëpunim opozitar. Në kohën kur ne po flasim, vendimi i ZRRE-së nuk është bërë publik. Çmimi i energjisë është rritur vetëm me tre rreshta. Ka pajtim që duhet të ketë protestë qytetare të përbashkët. Kemi dy ditë kohë që të pajtohemi për protestë. Njerëzit në protestë

nuk janë njerëz të PSD-së. Drejtuesit e partive duhet të jenë në valë të njëjtë me anëtarët e partisë", ka thënë Molliqaj. Sipas tij, Kosova ka nevojë për aksion opozitar duke potencuar se si PSD-ja do të vazhdojë me aksione të tjera. "Kosova ka nevojë për aksion opozitar. Nëse do të ishim bashkë atë ditë në shesh ky vendim nuk do të merrej. Mua më intereson që ky vendim të zbrapset sepse është i dëmshëm. Ne si PSD do t'i vazhdojmë aksionet. Nuk do të ndalemi. Unë jam optimist që edhe LDK-ja dhe PDK-ja nga presioni qytetar do të marrin pjesë në protestë", ka thënë Molliqaj.

përmirësuar standardin e jetës falë të ardhurave të fituara nga puna e familjarëve të tyre në Gjermani", ka shkruar Hoti në profilin e vet në "Facebook". Të njëjtën gjë e ka thënë edhe

ish-ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Enver Hoxhaj. "Njohja e patentë shoferëve të Kosovës dhe Shqipërisë nga Gjermania është lajm jashtëzakonisht i

mirë për të cilin është punuar gjatë. Me votën pro të të gjitha lendeve në Gjermani, tregohet miqësia e madhe mes dy vendeve tona. Faleminderit Gjermani!", ka shkruar Hoxhaj.

Marrëveshja bën një dallim për njohjen e patentave në varësi të datës së lëshimit të tyre. Patentat që janë lëshuar në Shqipëri pas datës 24 janar 2017 dhe në Kosovë pas datës 1

mars 2018 njihen menjëherë. Patentat e lëshuara para këtyre datave do të kontrollohen më parë nga Enti Federal i Transportit Motorik (Kraftfahr-Bundesamt).

Ambasadori gjerman viziton Prizrenin

PRIZREN, 11 SHKURT (ER) - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur në takim ambasadorin e Gjermanisë, Joern Rohde. Në këtë takim është biseduar për bashkëpunimet që mund të realizohen në mes dy

palëve në të ardhmen dhe për mundësitë e mbështetjes për komunën e Prizrenit nga ambasada dhe agjencitë e qeverisë gjermane që funksionojnë në Kosovë. "Fokusi kryesor i tyre, për ta mbështetur komunën tonë, do të jetë në

aktivitetet dhe projektet për nxitjen dhe zhvillimin e turizmit e kulturës, po ashtu projektet për zhvillimin e ekonomisë, infrastrukturës dhe për përmasimin e kualitetit të jetës së qytetarëve", ka thënë kryetari Totaj.



Kryetari i Podujevës merr përkrahje nga ministri Damka për ndërtimin e Tregut të Gjelbër

PODUJEVË, 11 SHKURT (ER) - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka pritur të premten në takim ministrin e Zhvillimit Rajonal (MZHR), me të cilin ka biseduar për projektet që po zhvillohen nga bashkëpunimi i komunës së Podujevës me këtë ministri. Gjatë këtij takimi kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, e ka falënderuar ministrin Damka për investimet e kësaj ministrie në projektet e përbashkëta me komunën dhe ka diskutuar për mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit. "Falënderova ministrin Damka për bashkëpunimin që kemi për realizimin e projekteve infrastrukturore që po zhvillohen në komunën tonë, gjithashtu shprehja nevojën për ndihmë nga kjo ministri edhe në projektet e reja siç është projekti për Stacionin e Autobusëve, projekt për të cilin u zotua ta fillojmë brenda këtij viti", ka thënë kryetari Bulliqi.

Në takim Bulliqi ka theksuar edhe nevojën për një dinamikë të re në zbatimin e projekteve që janë në



realizim siç janë urat në fshatrat Bajçinë dhe Sfeçël.

Edhe ministri Damka ka shprehur gatishmërinë për punë për

përmbylljen e projekteve të nisura dhe u zotua për përkrahje të komunës në projektet e reja. Në këtë takim kryetari Bulliqi ka

paraqitur edhe nevojën për ndërtimin e Tregut të Gjelbër, projekt për të cilin mori mbështetje nga ministri Damka, i

cili është zotuar për ndihmë përmes formës së bashkëfinancimit me komunën e Podujevës.



Hamza premton përkrahje institucionale për të verbërit

MITROVICË, 11 SHKURT (ER) - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka pritur të premten në takim përfaqësuesit nga Shoqata e të Verbërve të Kosovës, të prirë nga kryetari i saj Daut Tishuku, si dhe kryetarin e Shoqatës Ndërkomunale të Verbërve në Mitrovicë, Skender Kerolli. Në këtë takim është diskutuar për rolin dhe prioritetet e kësaj

kategorie si dhe për vazhdimin e bashkëpunimit të kësaj shoqate me komunën e Mitrovicës. Me këtë rast, kryetari Hamza ka theksuar se qeverisja lokale do të jetë sa më afër qytetarëve të komunës dhe do t'i shqyrtojë mundësitë financiare që t'u dilet në ndihmë të gjitha kategorive të qytetarëve, përfshirë këtu edhe komunitetin e të verbërve.

Komuna e Prishtinës rrënon një mbindërtim në lagjen "Dardania"

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Drejtoria e Inspeksionit në Prishtinë, pas njoftimit për mbindërtimet që po zhvilloheshin në hapësirat e një objekti kolektiv në lagjen "Dardania", ndërmori

menjëherë masa për rrënimin e punimeve. "U bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve të Prishtinës që të heqin dorë nga çdo lloj ndërtimi që nuk përkon me ligjin. Mirëkuptimi dhe

bashkëpunimi i qytetarëve me organet e komunës është jetik për transformimin e Prishtinës", ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" kryetari i kryeqytetit, Përparim Rama.



Dorëzohen 80 kallëzime penale për krime lufte në Gjakovë

PRISHTINË, 11 SHKURT - Shoqata për Krimet e Luftës "Gjakova 98-99" ka dorëzuar në Departamentin për Krime Luftë në Policinë e Kosovës, 80 kallëzime penale që, sipas saj, lidhen me krimet e luftës të kryera nga forcat policore e ushtarake serbe në periudhën e luftës së fundit. Drejtuesja e kësaj shoqate, Shkëndije Hoda, ka thënë të premten se janë dorëzuar 80 kallëzime penale, në mesin e tyre edhe një kallëzim penal nga një viktimë e dhunës seksuale. "Kësaj here i kemi sjellë 80 lëndë, do të thotë 80 kallëzime penale që kanë të bëjnë zakonisht me vrasje, tortura dhe dëme materiale të shkaktuara gjatë kohës së luftës. Sot nëpërmes shoqatës sonë kemi edhe një padë për një viktimë të dhunës seksuale, e cila ka ngritur kallëzim penal ndaj tre kriminelëve, të cilët i ka njohur dhe i ka identifikuar në zyrën tonë", ka thënë Hoda, duke shtuar se deri më tani shoqata që ajo drejton ka dorëzuar në hetuesi 15 kontingjente me dokumentacione që lidhen me krimet e luftës. E njëjta shoqatë ka dorëzuar edhe

në të kaluarën dokumentacione që, sipas saj, dëshmon krimet e kryera nga forcat policore dhe ushtarake serbe gjatë kohës së luftës. Drejtuesja e kësaj shoqate kanë thënë se dosjet që dorëzuara përmbajnë materiale me dëshmi dhe dokumentacione të rëndësishme që do t'u ndihmojnë hetuesve për zbardhjen e vrasjeve dhe të dhunës së ushtruar ndaj popullatës civile. Ata kanë sqaruar se në këto dokumentacione ka dëshmi që shërbejnë për të dëshmuar raste të dhunës, maltretimeve fizike, vrasjeve dhe shkatërrimit të pasurisë. Gjakova konsiderohet ndër komunat që ka pësuar më së shumti në luftën e viteve 1998-'99. Në këtë qytet janë vrarë rreth 1 200 persona. Sipas Fondit për të Drejtën Humanitare - Kosovë, komuna e Gjakovës ka numrin më të madh të personave të pagjetur. Në të gjithë territorin e Kosovës gjatë periudhës së luftës u vrarë rreth 14 mijë persona. Nga viti 2000 deri në vitin 2008 krimet e luftës në Kosovë janë hetuar nga Misioni i Organizatës së Kombeve



të Bashkuara (UNMIK). Nga viti 2008, hetimin e krimeve të luftës e kishte përgjegjësi Misioni Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX). Në vitin 2018 misioni i EULEX-it përfundoi procesin e dorëzimit të dosjeve te prokuroria dhe gjykatat vendore. Sipas EULEX-it, ky mision kishte dorëzuar 495 dosje policore të krimeve të organizuara, 434 dosje

policore të krimeve të luftës, dosje policore për persona të pagjetur, dosje gjyqësore që janë shqyrtuar vetëm nga EULEX-i, dhe më shumë se 1 400 dosje prokuroriale. Organizatat vendore që monitorojnë sistemin e drejtësisë kanë thënë se hetimi i krimeve të luftës nuk ka qenë efikas. Një hulumtim mbi gjykimin e

krimeve të luftës i publikuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) në vitin 2021, ka vënë në pah se nga muaji tetor i vitit 1999 deri në qershor 2020, nga gjyqtarët e UNMIK-ut, EULEX-it dhe ata vendorë, me aktgjykime të formës së prerë janë dënuar gjithsej 40 persona. Prej tyre, sipas IKD-së, 35 janë shqiptarë dhe katër serbë. /Rel/

Krasniqi takon Bashën: Bashkëpunimi Kosovë - Shqipëri mbetet prioritet i prioriteteve

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

TIJANË, 11 SHKURT - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, në ditën e dytë të vizitës së tij zyrtare në Tiranë, ka takuar kryetarin e Partisë Demokratike të Shqipërisë, Lulzim Basha, ku kanë diskutuar për zhvillimet aktuale politike në Kosovë dhe Shqipëri dhe thellimin e bashkëpunimit në mes të PDK-së dhe PD-së. Krasniqi u shpreh i kënaqur për mikpritjen dhe falënderoi Bashën për gatishmërinë e tij për përforcimin e bashkëpunimit mes dy partive që i përkasin boshtit të njëjtë ideologjik. "Vërtet është kënaqësi që ditën e dytë të vizitës sime të parë zyrtare si kryetar i PDK-së ta filloj në Partinë Demokratike këtu në Shqipëri me mikun tim dhe liderin e opozitës Lulzim Basha, jo vetëm si dy liderë të opozitës në dy vendet tona, por edhe si dy udhëheqës partish që kanë pasur bashkëpunim për shumë vite edhe bilateralisht, por edhe në forume ndërkombëtare si dy parti që i përkasin boshtit të njëjtë ideologjik të qendrës së djathtë", ka thënë ai. Lideri i PDK-së ka theksuar se përtej kësaj në takim u diskutua në detaje për tema të brengave të përbashkëta. "Kosova dhe Shqipëria kanë shumë sfera ku

ka nevojë të shtojë bashkëpunimin që ta rritin koordinimin edhe institucional dhe gjithmonë ka qenë dhe është shembull i mirë se, pavarësisht se a jemi në qeveri apo në opozitë në vendet tona, ne bashkëpunimin Kosovë - Shqipëri, Shqipëri - Kosovë e kemi të padiskutueshëm dhe prioritet të prioriteteve, andaj gëzohem që edhe si dy udhëheqës të partive kryesore opozitare në Kosovë dhe Shqipëri e vlerësojmë që obligimet dhe përgjegjësitë tona për të thelluar këtë bashkëpunim ndërmjet shteteve tona janë detyra dhe përgjegjësi të përbashkëta", është shprehur Krasniqi. Ndërkaq kryetari i PD-së, Lulzim Basha, ka përgëzuar PDK-në për rolin e jashtëzakonshëm që ka luajtur në procesin e formimit të shtetit të Kosovës dhe për rolin që vazhdon të luajë si opozitë konstruktive në shërbim të interesave të qytetarëve të Kosovës, si dhe i uroi punë të mbarë kryetarit Memli Krasniqi si përfaqësues i një brezi të ri të liderit dhe si shembull i mirë për tërë rininë shqiptare se është koha për të mbajtur mbi supe barrën që sjellë politika. "Natyrisht, folëm për zhvillimet e fundit, në veçanti sa iu takon zhvillimeve të dialogut midis Republikës së Kosovës dhe Serbisë, ku PDK-ja qëndron



fuqimisht në të njëjtin pozicion sa i takon objektivit të këtij dialogu, që është njohja e ndërsjellë mes dy vendeve, në veçanti ndan pikëpamjen se rikthimi i një koordinimi të fuqishëm mes shteteve të BE-së dhe ShBA-së është një shans e mirë për të shtyrë përpara këtë dialog dhe për t'i tejkaluar pengesat, ku sigurisht një barrë e madhe i përket BE-së dhe pesë vendeve anëtare, njohja prej të cilave e realitetit të Republikës së Kosovës do të shmangë përfundimisht çdo skenar si ato në Bosnjë Hercegovinë që kërcënojnë arkitekturën e paqes dhe stabilitetit në Ballkan, por edhe vetë paqen dhe stabilitetin

evropian", ka deklaruar ai. Basha ka theksuar se diskutuan edhe rreth domosdoshmërisë së forcimit të luftës kundër korrupsionit nga institucionet e pavarura dhe të gjitha këto në funksion të mirëqenies qytetare, sepse armiku kryesor i mirëqenies qytetare si në Shqipëri si në Kosovë mbeten institucionet e dobëta dhe lufta kundër korrupsionit, e cila duhet të jetë prioritet i secilit politikan nga cilado pozitë. "Ndërkohë Shqipëria ka një detyrë të përhershme, por në momentin aktual edhe më të rëndësishme si anëtare e përkohshme e Këshillit të Sigurimit të shtytë me të gjitha

forcat dhe mënyrat përpara çdo aspekt që ka të bëjë me Kosovën dhe qytetarët e saj, në veçanti për vazhdimin e njohjes ndërkombëtare, atë të anëtarësimit në institucionet ndërkombëtare dhe Partia Demokratike këtu jo vetëm që nuk do të reshtë së shtyri jo vetëm nga pozitat e opozitës aktualisht, por edhe nuk do të kursejë asgjë që Shqipëria të japë gjithçka që mundet në mënyrë që Kosova të ketë përfitime maksimale të një bashkëpunimi të vërtetë, të ngushtë dhe produktiv midis Shqipërisë dhe Kosovës në rrafshin politik dhe ekonomik", ka thënë Basha.

Rasti i 2.1 milionë eurove, Labinot Gruda e pranon fajësinë

PRISHTINË, 11 SHKURT - Labinot Gruda, një nga të pandehurit në rastin e vjedhjes së 2 milionë eurove nga Thesari i Shtetit, të premtën e ka pranuar fajësinë. Gruda u deklarua fajtor për të gjitha pikat e akuzës në seancën e mbajtur të premtën në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Më 21.12.2021 Gjykata Themelore në Prishtinë ka konfirmuar aktakuzën ndaj të akuzuarve Labinot Gruda dhe Kadri Shala, të cilët ngarkohen se i shkaktuan dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në vlerë prej 2 milionë e 77 mijë e 995 eurosh e 90 centë. Në aktakuzë thuhet se Gruda akuzohet për veprat penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar", "Hyrja në sistemet kompjuterike", "Vjedhja e identitetit dhe pajisja e qasjes" dhe "Shpëlarje e parasë" lidhur me nenin 56 të Ligjit për Parandalimin e shpëlarjes së parasë dhe financimin e terrorizmit, në bashkëpunim me të pandehurin Shala.

"Avullimi" i 2.1 milionë eurove nga Thesari i Shtetit, këto janë akuzat që rëndojnë mbi Labinot Grudën dhe Kadri Shalën.

"Avullimi" i 2.1 milionë eurove nga Thesari i Shtetit, këto janë akuzat që rëndojnë mbi Labinot Grudën dhe Kadri Shalën.

Ndërkaq, thuhet se Shala akuzohet për veprat penale "Shpëlarje e parasë" lidhur me nenin 56 të Ligjit për Parandalimin e shpëlarjes së Parasë dhe Financimin e Terrorizmit, në bashkëpunim me të pandehurin Gruda dhe "Ndihma", në ndërlidhje me veprën penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar".

Në aktakuzë thuhet se Labinot Gruda veprat penale që i vihen në barrë i kreu në cilësinë e personit zyrtar, me pozitë menaxher i tavolinës ndihmëse për Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK) në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve-Thesari i Shtetit, ndërsa Kadri Shala ishte i autorizuar ligjor në kompaninë "LDA Group SHPK".

Sipas PSRK-së, si pasojë e veprimeve inkriminuese të të pandehurve Labinot Gruda dhe Kadri Shala buxhetit të Republikës së Kosovës, i është shkaktuar dëm në vlerë prej 2 milionë e 77 mijë e



995 eurosh e 90 centë. "Lidhur me këtë, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka kërkuar konfiskimin e katër (4) veturave të cilat janë rrjedhojë e këtij aktiviteti kriminal, shumën e të hollave të cilat janë ngrirë me urdhër të gjykatës, si dhe nga ana e të pandehurve të bëhet kompensimi i humbjes apo dëmit të shkaktuar buxhetit të Republikës së Kosovës, deri në përmbushjen e vlerës së dëmit të shkaktuar si rezultat i veprave penale ose, në të kundërtën, gjykata lidhur me këtë të konfiskojë çdo pasuri të të pandehurve deri në kompensimin e plotë të dëmit të shkaktuar buxhetit të Republikës së Kosovës", thuhej në komunikatën e PSRK-së.

Gjithnjë sipas aktakuzës, Labinot Gruda më 9 tetor 2020, me qëllim të përfitimit në mënyrë të kundërligjshme të dobisë pasurore për vete dhe të tjerët, dhe për t'i shkaktuar dëm buxhetit të Republikës së Kosovës, në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e vendit të punës ka ndërhyrë në ndarjen buxhetore

dhe ka transferuar shumën prej 2 milionë e 77 mijë e 995 eurosh e 90 centë në llogarinë bankare në emër të "LDA GROUP", SH.PK. Sipas aktakuzës, Gruda është kyçur në SIMFK dhe ia ka shtuar userit të tij mundësinë e shtimit të klasës funksionale në sistem, me ç'rast ka regjistruar furnitorin

"LDA GROUP" SH.PK, më pastaj ka krijuar përdoruesit fiktivë përmes të cilëve ka ndërmarrë veprimet për qasje për urdhër-bletje, për pranim të mallit dhe krijim të kuponëve të shpenzimit, si dhe ka ndërruar fjalëkalimin e përdoruesit ekzistues "FAZLIUF" (Fadil Fazliu), i cili kishte qasje në

sistem si zyrtar certifikues i Ministrisë së Infrastrukturës, përmes të cilit ka certifikuar kuponët e shpenzimit për operatorin "LDA GROUP" SH.PK., me ç'rast Thesari i Kosovës sipas procedurave standarde të SIMFK-së, ka ekzekutuar pagesat në llogari të këtij operatori.

Bajrami: Do ta denoncojë secilin krim e secilën vjedhje që ndodh

Ish-ministria e Ekonomisë, Hykmete Bajrami, ka reaguar pasi i akuzuari për vjedhjen e 2.1 milionë eurove të thesarit, Labinot Gruda, e pranoi fajësinë. Bajrami ka thënë se gjithmonë do të denoncojë çdo krim dhe vjedhje që ndodh. Kjo pasi, sipas saj, ka qenë vetë ajo që e ka denoncuar Grudën për vjedhjen e 2.1 milionë eurove të thesarit. "E denoncova, dikush e pa si faj, e pranoi këtë faj. Kam pranuar me qindra mesazhe

përkrahëse që kam denoncuar vjedhjen e 2.1 milionë eurove. Dhjetëra e qindra reagime nëpër rrjete sociale e kërcënime pse kam denoncuar. Sot, kur i akuzuari kryesor e pranoi fajin, po e pranoi edhe unë një faj. Fajin se e kam denoncuar. Dje, sot, nesër dhe përgjithmonë do të bëj të njëjtin faj. Prapë do ta denoncoj secilin krim e secilën vjedhje që ndodh. Nuk jam dorëzuar dhe nuk dorëzohem as nga ata që kanë tentuar të

më ndalin të flasë e denoncoj paligjshmëri e shkelje ligjore të tjera. Prandaj, sot, është ditë e madhe për drejtësinë. Është ditë e madhe për Kosovën. Menjëherë duhet të nisë kthimi i parave në buxhetin e Kosovës. Drejtësia duhet ta kryejë detyrën deri në fund pasi i akuzuari ka pranuar fajin dhe ka hapur rrugën për sqarimin e 2.1 milionë eurove deri në fund", ka shkruar Bajram në "Facebook".

Kapen cigare të kontrabanduara



PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Dogana e Kosovës ka njoftuar se në magjistralen Aeroport - Prishtinë njësitet antikontabande kanë arritur të identifikojnë dhe ndalojnë një automjet transportues të dyshimtë. Me këtë rast janë gjetur cigare të kontrabanduara, pa dokumentacion përcjellës me vlerë prej 12 000.00 eurosh.

Sipas Doganës së Kosovës, shmangiet nga detyrimet doganore llogaritet të jenë 63 756.00 euro. "Lidhur me këtë rast është njoftuar Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe pas intervistimit me urdhër të prokurorit kujdestar dy të dyshuarit janë arrestuar dhe dërguar në mbajtje. Dogana e Kosovës, në bashkëpunim me autoritetet kompetente,

do të vazhdojë të ushtrojë kontrolle në kuadër të realizimit të detyrave dhe përgjegjësi të saj, me qëllimin e vetëm parandalimin e veprimtarive ilegale në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës", është thënë në njoftimin e Doganës dhe u është bërë thirrje qytetarëve t'i lajmërojnë rastet te zyrtarët doganorë.

Ja pse Putini përfiton shumë më tepër nga bllofi, sesa nga lufta kundër Ukrainës

Nga Ivan KRASTEV
"New York Times"


Në javët e fundit të Luftës së Parë Botërore, një gjeneral gjerman u dërgoi një telegram aleatëve të tij austriakë, duke e përmbledhur kështu situatën. "Situata është serioze, por jo katastrofike!". Pak orë më vonë mbërriti përgjigja e austriakëve: "Këtu situata është katastrofike, por jo serioze!". Sigurisht që kjo është një shaka, por që përmbledh më së miri mosmarrëveshjen aktuale midis Amerikës dhe Evropës sa i përket situatës në Ukrainë. Për Shtetet e Bashkuara dhe presidentin Joe Biden, që miratoi zyrtarisht të mërkurën një dislokim të trupave amerikane në Evropën Lindore, një pushtim rus i udhëhequr nga presidenti Vladimir Putin është një "mundësi realiste". Për Evropën, jo dhe aq. Një diplomat i lartë gjerman e përmbledhi me pak fjalë këtë divergjencë: "SHBA mendon se Putin do të nisë një luftë në shkallë të plotë ndaj Ukrainës. Ndërkohë evropianët mendojnë se ai po luan bllofin". Ndoshta kjo mosmarrëveshje është e pritshme. Tek e fundit, për një publik evropiano-perëndimor lufta në shkallë të gjerë, është përgjithësisht po aq e paimagjinueshme sa edhe një pushtim alien.

Dekadat e shumta të paqes në Evropën Perëndimore, të kombinuara me varësinë e thellë të kontinentit nga nafta dhe gazi i Rusisë, i nxisin zyrtarët evropianë të supozojnë se lëvizjet agresive ruse duhet të jenë me siguri një hile e Kremlinit.

Por tendenca evropiane për të pasur një qasje më të butë ndaj Rusisë pikërisht në këto momente, nuk shpjegon arsyen se pse pas alarmimit fillestar, edhe zyrtarët ukrainas duket se ndajnë tashmë të njëjtën pikëpamje me ta.

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, e minimizoi javën e kaluar kërcënimin e menjëhershëm të luftës, duke deklaruar se situata ishte "e rrezikshme, por e paqartë". Për një vend të kërcënuar nga 130.000 trupa ruse në kufi, ky është një vlerësim i habitshëm. Po çfarë fshihet pas tij?

Përgjigja është befasuese, madje paradoksale. Evropianët dhe ukrainasit janë skeptikë ndaj një pushtimi të madh rus në Ukrainë, jo sepse ata kanë një pikëpamje më të mirë mbi Vladimir Putinin sesa homologët e tyre amerikanë. Përkundrazi, kjo ndodh sepse ata e shohin atë si më



keqdashës.

Lufta, arsyetojnë ata, nuk është loja thelbësore e Kremlinit. Përkundrazi, loja kryesore bazohet tek një grupim i madh taktikash që janë të dizenuara të destabilizojnë Perëndimin. Për Evropën, kërcënimi i luftës mund të rezultojë të jetë më shkatërrues sesa vetë lufta. Amerika dhe Evropa nuk janë të ndara mbi atë që dëshiron të arrijë presidenti rus. Me gjithë spekulimet rreth motiveve të tij, shumë gjëra janë tanimë të qarta: Kremlini dëshiron një shkëputje simbolike nga vitet 1990, duke e varrosur rendin ndërkombëtar të pas Luftës së Ftohtë.

Kjo e fundit duhet të marrë formën e një arkitekture të re evropiane të sigurisë, që njeh sferën ruse të ndikimit në hapësirën post-sovjetike, dhe që e hedh poshtë universalitetin e vlerave perëndimore. Në vend të ri-ngritjes së Bashkimit Sovjetik, qëllimi është rimëkëmbja e asaj që Putin e konsideron si Rusia historike. Ky mesazh është përcjellë si në Uashington po ashtu edhe në Bruksel. Ndërkaq, në të dyja anët e Atlantikut ekziston një marrëveshje e përgjithshme se çfarëdo që të bëjë më pas, Kremlini nuk do të qëndrojë palëvizur. Pra Rusia nuk do të tërhiqet në heshtje. Por ndërsa amerikanët priren të

besojnë se Putin ka nevojë për një luftë të nxehtë në Ukrainë që të përmbushë ambiciet e tij të mëdha, evropianët, dhe me sa duket ukrainasit besojnë se një strategji hibride – që përfshin praninë ushtarake në kufi, përdorimin si armë të furnizimeve me energji dhe sulmet kibernetike – do t'i shërbente më mirë.

Dhe kjo qasje bazohet në disa arsytetime logjike. Një inkursion rus në Ukrainë, mund ta shpëtojë rendin aktual evropian. NATO nuk do të kishte zgjidhje tjetër, veçse të kundërpërgjigjej me vendosmëri, duke vendosur sanksione të ashpra ndaj Rusisë, dhe duke vepruar në unitet.

Duke e përshkallëzuar konfliktin, Vladimir Putin mund të bashkojë kundërshtarët e tij. Përkundrazi, frenimi mund të ketë efektin e kundërt: pa një pushtim, politika e presionit maksimal, mund të përfundojë duke e përçarë dhe paralizuar NATO-n.

Për të parë se si mund të ndodhë kjo, mjafton të shohim Gjermaninë. Para krizës, Gjermania ishte aleatja më e ngushtë e Amerikës në Evropë. Por ndërkohë ajo mburrej se kishte një marrëdhënie të veçantë me Moskën, dhe se ishte partnerja më e rëndësishme për Evropën

Lindore dhe atë Qendrore.

Ndërkohë që sot disa zyrtarë në Uashington kanë vënë në pikëpyetje gatishmërinë e këtij vendi për t'u përballur me Rusinë, marrëdhëniet e Berlinit me Moskën po përkeqësohen me shpejtësi, dhe shumë evropiano-lindorë janë të shqetësuar nga ngurrimi i dukshëm i Gjermanisë për t'i mbështetur aleatët.

Vështirësitë e Gjermanisë janë një shembull i asaj që mund të ndodhë nëse Putin vazhdon kërcënimet e tij, por pa kaluar tek një pushtim faktik. Dhe më e rëndësishmja, nuk ka ndryshuar Gjermania, por bota në të cilën ajo vepron.

"Pozicioni i saj, është ai i një treni që qëndron pa lëvizur, edhe pasi stacioni hekurudhor ka marrë flakë" – më tha Bojan Pancevski, korrespondenti i "The Wall Street Journal" për Gjermaninë. Sot, forca gjeopolitike nuk përcaktohet nga fuqia ekonomike që zotëron një shtet, por nga sasia e dhimbjes që mund të durosh.

Në dallim nga koha e Luftës së Ftohtë, armiku nuk është dikush që ndodhet pas Perdes së Hekurt, por dikush me të cilin bëni tregti, nga i cili merrni gaz, dhe tek i cili eksportoni mallra të teknologjisë së lartë. Fuqia e butë i ka lënë vendin elasticitetit.

Dhe ky është një problem për Evropën. Nëse sukcesi i Putin do të përcaktohet nga aftësia e shoqërive perëndimore për t'u përballur me presionin e çmimeve të larta të energjisë, keqinformimit dhe paqëndrueshmërisë politike gjatë një periudhe të gjatë, atëherë ai ka arsye të mjaftueshme për të shpresuar.

Siç qëndrojnë gjërat, Evropa është dukshëm e papërgatitur për këto sfida. Korrigjimi i kësaj situate, nëpërmjet investimeve tek kapacitetet ushtarake, diversifikimit të energjisë dhe ndërtimit të kohezionit social, duhet të jetë fokusi kryesor i kontinentit.

Evropianët kanë të drejtë të besojnë se pushtimi i Ukrainës nga Rusia nuk është i pashmangshëm. Madje mund të jetë e saktë të thuhet se nuk është skenari më i mundshëm. Por ne nuk mund ta mashtrojmë veten se mund ta kapërcejmë testin e qëndrueshmërisë. "Nëse fton një ari të kërcëjë, nuk je ti që e vendos se kur përfundon vallëzimi, por ariu" – thotë një proverb rus.

Shënim: Ivan Krastev, është anëtar i përhershëm në Institutin për Shkenca Humane në Vjenë, dhe ekspert i politikës ndërkombëtare.



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Drita me fitore synon ta nisë sezonin pranveror

Trajneri Ardian Nuhui ka thënë se skuadra e Dritës është e gatshme për ndeshjen e parë të pranverës ndaj Feronikelit. "Të shtunën do të kemi një kundërshtar që duhet ta vlerësojmë dhe respektojmë në maksimum, sepse duke vlerësuar kundërshtarin do të tregojmë dhe respektojmë edhe vlerat tona si skuadër. I gjithë fokusi për ndeshjen është një trepikësh shumë i rëndësishëm për skuadrën tonë", ka thënë Nuhui

EPOKA
ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 SHKURT - Skuadra e Dritës së Gjilanit është përgatitur maksimalisht për sezonin pranveror. Trajneri i kësaj skuadre, Ardian Nuhui, ka mbajtur konferencë për medie një ditë para ndeshjes së parë kundër Feronikelit nga ora 13:00 në stadiumin e Ulpianës në Lipjan. "Të shtunën do të kemi një kundërshtar që duhet ta vlerësojmë dhe respektojmë në maksimum, sepse duke vlerësuar kundërshtarin do t'i tregojmë dhe respektojmë edhe vlerat tona si skuadër. I gjithë fokusi për ndeshjen është një trepikësh shumë i rëndësishëm për skuadrën tonë", ka thënë Nuhui. "Në fazën përgatitore parasezonale kemi punuar në aspektin fizik, taktik dhe psikologjik të skuadrës. Jemi munduar të marrim më të mirën nga futbollistët. Kemi zhvilluar ndeshje shumë cilësore në Turqi me kundërshtarë të fortë dhe në ndeshje të tilla e vlerëson skuadrën se sa është përmirësuar. Jemi munduar ta përmirësojmë çdo detaj, të kompletohemi dhe të jemi sa më të balancuar e të reagojmë kur duhet. Jam munduar që skuadrën ta përgatis edhe në aspektin psikologjik dhe ta bind se duhet të fitohet çdo ndeshje, sepse do të jetë një garë e fortë me rivalitet deri në fund të kampionatit", ka shtuar Nuhui. Në konferencë për medie ishte edhe futbollisti Leotrim Rexhepi, i



cili ka deklaruar se Drita është e përgatitur, e fokusuar dhe gati për pjesën tjetër të edicionit në Superligë. "Faza përgatitore ka shkuar shumë mirë dhe jemi përgatitur në të gjitha aspektet. Jemi përgatitur maksimalisht për një fillim kampionati të mbarë. I njohim cilësitë e Feronikelit dhe në situatën në të cilën gjendet, do të vazhdojmë t'u qasemi me seriozitet ndeshjeve një nga një për të marrë më të mirën", ka thënë Rexhepi. Feronikeli pritet që në këtë ndeshje të paraqitet me futbollistë juniorë, pasi shumica e lojtarëve titullarë janë larguar nga klubi në afatin kalimtar të janarit. Kjo skuadër thuhet tashmë është pajtuar se do të bjerë nga elita. Drita është e dyta në tabelë me një pikë më pak se Gjilani që është lider, kurse "Nikli"

pozicionohet në vendin e fundit me 11 pikë. Sot (e shtunë) zhvillohet edhe dy ndeshje të tjera ku takohen Ballkani me Dukagjinin, kurse Drenica përballet me Gjilanin. Dy ndeshje të tjera të kësaj jave zhvillohen të dielën, kurse takohen Malisheva - Prishtina dhe Llapi - Ulpiana.

SUPERLIGA - Java 19

Të shtunën takohen:
13:00 Ballkani - Dukagjini
13:00 Drenica - Gjilani
13:00 Drita - Feronikeli

Të dielën takohen:
13:00 Malisheva - Prishtina
13:00 Llapi - Ulpiana

Hendbolli fillon me shumë derbi

Prishtinë, 11 shkurt - Ndeshje interesante dhe cilësore priten në xhiron e parë të stinorit pranveror të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Ndeshjet e xhiros së 15 të kampionatit të Kosovës në hendboll luhen këtë fundjavë. Janë disa ndeshje që priten të jenë të bukura për tifozët e hendbollit. Dy skuadrat me traditë, Besa Famgas e Kastrioti, takohen të dielën në orën 18:00. Me marrëveshje të dy skuadrave, kjo ndeshje luhet në Ferizaj. Kastrioti së fundi ka angazhuar disa lojtarë të huaj dhe sinjalet e përmirësimit priten t'i japë që në



këtë ndeshje. Ndërkohë Besa Famgas synon të vazhdojë me fitore. Skuadra pejane Besa Famgas udhëheq në tabelë me 28 pikë. I ka fituar 14 ndeshjet e deritashme. Kastrioti është i pesti me 14 pikë. Vëllaznimi - Llapi është tjetër ndeshje me peshë që

luhet të dielën. Kjo ndeshje zhvillohet në Gjakovë nga ora 17:30. Vëllaznimi i ka 10 pikë në vendin e gjashtë, aq sa edhe Llapi në të shtatin. Është ndeshje me rëndësi për Superligën A. Të shtunën janë tri ndeshje. Vëmendja do të jetë në kryeqytet ku takohen Prishtina e Trepça. Ndeshja e dy skuadrave të kreut fillon në orën 19:00. Në Mitrovicë, në vjeshtë, Prishtina kishte fituar me një gol dallim. Andaj me të drejtë priten lojë e fortë dhe interesante. Dy ndeshjet e tjera të së shtunës janë Deçani - Zhegra (19:00), Rahoveci - Drenica (19:00).

SHKURT

Sekretari i KOK-ut takohet me presidenten e Komitetit Olimpik të Izraelit

Sekretari i përgjithshëm Besim Aliti takoi presidenten e KO të Izraelit, Yael Aradi. Në vazhdim të takimeve me drejtues të Komiteteve Olimpikë Kombëtare, sekretari i përgjithshëm i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Aliti, ka zhvilluar takim me presidenten e Komitetit Olimpik të Izraelit, Yael Aradi. Në takimin e mbajtur në Pekin të Kinës, ku po mbahen Lojërat Olimpikë Dimërore Pekini 2022, palët diskutuan për programet e të dyja komiteteve olimpikë, pjesën profesionale të përgatitjes sportive, programet sportive në shtet, financimin etj. Të dyja komitetet olimpikë u pajtuan që ta thellojnë bashkëpunimin si dhe ta vizitojnë njëra-tjetrën në një të ardhme të afërt.

Gruaja e Valon Behramit fiton medaljen e artë në ski

Lara Gut-Behrami ka fituar medaljen e artë në Lojërat Olimpikë që po zhvillohen në Pekin. Zvicëria zhvilloi një paraqitje fantastikë në garat me ski. Edhe pse nuk e nisi garën mirë, Lara përsëri arriti të dilte triumfuese në fund. "Thjesht bëra ski, asgjë më shumë e as më pak. Shpesh ne ngarkohemi shumë psikologjikisht kur vjen puna te Lojërat Olimpikë. Sot e dija që do të ishte gara ime e fundit dhe doja të bëja një paraqitje të mirë dhe jam shumë e lumtur", u shpreh skiatorja pas garës.

Strakosha, afër largimit nga Lazio

Tomas Strakosha me shumë mundësi nuk do ta rinovojë kontratën me klubin e Lazios. Portieri shqiptar nuk ka pranuar asnjë ofertë nga kryeqytetasit për të rinovuar dhe e ardhmja e tij shihet larg klubit. Për momentin nuk ka pasur asnjë kontakt me ndonjë klub tjetër. Strakosha është në konkurrencë të vazhdueshme me Pepe Reinën dhe trajneri Sarri preferon spanjollin si titullar të portës. Kontrata e Strakoshës përfundon në fund të sezonit dhe më pas do të jetë i lirë të largohet me parametër zero.

Uzuni: Transferimi në Granada, një ëndërr e bërë realitet

Sulmuesi shqiptar Myrto Uzuni, pas suksesit në Hungari me Ferencvaros, bëri hapin e madh në karrierë duke iu bashkuar skuadrës spanjolle Granada. Debutimi i shqiptarit me këtë skuadër erdhi në "Santiago Bernabeu" kundër Real Madridit, ku reprezentuesi shqiptar bëri një ndeshje shumë të mirë. "Dua t'i falënderoj ata që gjenden këtu sot. Dua ta falënderoj trajnerin që besoi tek unë dhe më solli këtu. Jam gati të nis këtë aventurë të re. Sa për Granadën, historia flet vetë", ka thënë Uzuni. "La Liga është një ndër kampionatet më të forta në botë. E njihja që nga sezoni i kaluar kur ky klub u ndesh me skuadrën e Teutës në Ligën e Evropës. Gjithashtu, këtu ka luajtur edhe miku im Rey Manaj kështu që di shumë për këtë klub", ka shtuar ai. 26-vjeçari ka thënë se për të është një ëndërr e bërë realitet që është transferuar në La Liga, derisa ka premtuar se do të shënojë shumë gola. "Për mua ishte një ëndërr e bërë realitet. Ishte një ndeshje e vështirë ajo që luajtëm në 'Santiago Bernabeu'. Ne kemi lojtarë të mirë. Unë mendoj se duke luajtur së bashku si një grup atëherë edhe rezultatet do të vijnë. Unë dua të shënoj gola, por në atë moment nuk kisha shumë mundësi, por besoj se në ndeshjet e tjera do t'ia dal", ka deklaruar Uzuni.

Erikseni: Më kujtohet gjithçka, përveç atyre pesë minutave kur ika nga kjo botë

Londër, 11 shkurt - Gjatë një interviste për BBC, Christian Eriksen ka rikujtuar çastet e tmerrshme kur u rrëzua në fushë gjatë ndeshjes në mes të Danimarkës dhe Finlandës, e vlefshme për Kampionatin Evropian. Pesë

minuta nga të cilat ai ishte "i ikur nga kjo botë, derisa iu rikthyen rrahjet e zemrës". "Arrij të kujtoj gjithçka, me përjashtim të atyre pesë minutave, pasi vetëm më vonë më thanë se kishin kaluar pesë minuta. Mbjaj


mend rivënien anësore, topin që më goditi te gjuri dhe më pas nuk e di çfarë ndodhi. Kur u zgjova, e pashë veten të rrethuar nga njerëz dhe fillova të ndiej goditjet në kraharor, por nuk e kuptoja çfarë po ndodhte.

Mendoja nëse kisha dëmtuar këmbën apo shpinën dhe nuk dija a do të lëviz më. Vetëm kur hipa në ambulancë dëgjova mjekët të thoshin se kisha mbetur pesë minuta pa ndjenja", ka thënë Eriksen.



Muriqi: Ushtarët serbë thanë se do të vendosnin një bombë në shtëpinë tonë

MALLORCA, 11 SHKURT - Vedat Muriqi, i cili luan për Mallorcën në Spanjë, ka bërë deklarata të veçanta për shtypin spanjoll. Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës ka folur për luftën në mes të Kosovës dhe Serbisë në fëmijërinë e tij dhe përvojat e dhimbshme që ka pasur derisa u bë futbollist profesionist. Në fund të viteve 1990, familja e tij, si shumë familje shqiptare të Kosovës, u detyruan të largohen në një eksod masiv në Shqipëri për t'u shpëtuar tmerreve të konfliktit të dhunshëm me Serbinë. Ata mund të ktheheshin në Kosovë vetëm dy muaj e gjysmë pasi u siguruan se jeta e tyre nuk ishte më në rrezik: "Pas luftës, pothuajse nuk kishte asgjë në Kosovë. Kur i thashë xhaxhait që doja të bëhesha futbollist, ai filloi të qeshte dhe më tha se ishte shumë e vështirë. Më pas gjërat filluan të ndryshojnë, pata fat dhe punova shumë për të qenë profesionist. Kjo nuk do të ishte e mundur pa fat, ndihmën e familjes sime dhe Zotit". "Lufta është gjëja më e keqe që mund t'i ndodhë botës dhe çdo njeriu. E vetmja gjë pozitive për këtë është se ju bën më të fortë mendërisht dhe fizikisht. Në familjen time ishin rreth 50 njerëz dhe të gjithë ishim të ngjuar në një dhomë të



një shtëpie. Kur gjermanët filluan të na ndihmonin, ne duhej t'u shpërndanim të gjithëve 1 litër qumësht dhe qepë në ditë. Ishin kohë të vështira, kuptova që familja ime po vuante, ne ishim fëmijë, donim të hanim e të pinim dhe nuk na jepnin asgjë. Për fat të mirë, askush nga familja ime nuk vdiq në luftë", thënë Muriqi. "Ushtarët serbë thanë se do të vendosnin një bombë në shtëpinë tonë. Mbjaj

mend që mamaja ime paketonte rrobat në çanta për të marrë makinën sa më parë dhe për të shkuar në Shqipëri. Ushtarët hodhën shumë rroba në rrugë. Nuk kam mundur të shoh asnjë futbollist si idhull në Kosovë. I shikoja ndeshjet dhe i bashkoja në kokë karakteristikat e shumë lojtarëve, por nuk mund të përmend vetëm njërin prej tyre si idhull", ka shtuar Muriqi.

Phoenixi e Miami, fitore dhe kryesim, tjetër humbje për Golden Staten

WASHINGTON, 11 SHKURT - Humbja e dytë brenda 24 orëve për Golden State, që u mund me rezultat 116-114 në sekondat e fundit nga New Yorku. Ndeshje e ekuilibruar, ku



për miqtë u dallua Randle me 28 pikë e 16 rebounde. Për Warriorsin, i zakonshmi Curry realizoi 35 pikë e 10 asistime, por që mbetën për statistikë. Në krye të renditjes në Perëndim qëndron Phoenixi, që sot mposhti me

rezultat 131-107 kampionët e Milwaukee. Ndeshje e dominuar nga vendasit, ku 7 lojtarë realizuan mbi 10 pikë. Shënuesi më i mirë ishte Ayton me 27 pikë. Miami rimerr kreun e renditjes në Lindje, pas fitores 112-97 ndaj New Orleansit, sfidë ku miqtë patën epërsi në fushë. Butler dhe Adebayo realizuan nga 29 pikë secili. Jashtë fushës fiton edhe Memphis, 132-107 ndaj Detroitit, ndeshje ku 7 lojtarë të Memphisit realizuan mbi 10 pikë (Ja Morant 23 pikë).

REZULTATET

Detroit - Memphis	107-132
New Orleans - Miami	97-112
Washington - Brooklyn	113-112
Houston - Toronto	120-139
Dallas - Clippers	112-105
Golden State - New York	114-116
Phoenix - Milwaukee	131-107

Unitedi në kërkim të një sulmuesi, ka katër opsione

Manchester Unitedi është në kërkim të një sulmuesi për edicionin e ri. "Dajtë e Kuq" kanë shënuar dy ose më shumë gola vetëm në tri ndeshje nga

dymbëdhjetë ndeshjet e fundit nën drejtimin e Ralf Ragnick. Mason Greenwood është pezulluar pas arrestimit të tij, ndërsa Anthony Martial nuk dëshiron të kthehet në

"Old Trafford" pasi iu bashkua Sevilas në formë huazimi. Cristiano Ronaldo dhe Edinson Cavani, i cili mbush 35 vjeç të hënën, duket se do të largohet këtë verë. Unitedi e ka

admiruar prej kohësh sulmuesin e Borussia Dortmundit, Erling Haaland, edhe pse Real Madridi duket se është zgjedhja e tij parësore. Harry Kane i Tottenhamit dhe

Dominic Calvert-Lewin i Evertonit janë dy emrat e tjerë që shihen si alternativa mjaft të mira, ndërkohë që në listën e dëshirave është edhe Lautaro Martinez.

SHKURT

Bare rikthehet për ndeshjen ndaj Barcelonës

Keidi Bare u stërvit të enjten me grupin dhe synon të rikthehet në mesfushë kundër Barçës në derbin e së dielës. Shqiptari ishte një mungesë e dukshme në skuadër për ndeshjen e fundit. Statusi zyrtar i tij pozitiv për Covid-19 nuk u bë i ditur, por disa burime treguan në të njëjtin drejtim. Të enjten, tri ditë më vonë, shqiptari tashmë ka mundur të stërvitet së bashku me pjesën tjetër të bashkëlojtarëve. Ai do të jetë gati për sfidën me Barcelonën.

Veteli 'zbulon' Aston Martin: Do të jetë sezoni i surprizave

Pas Haas dhe Bullit, një tjetër makinë e Formulës 1 është paraqitur në prag të sezonit të ri. Bëhet fjalë për Aston Martin, që do të quhet AMR22 dhe që do të pilotohet nga gjermani Sebastian Vettel e kanadezi Lance Stroll. Madje makina do të zbresë që në pistën e Silverstones, për të përshkruar 100 km e lejuara për "filmin day" (dita e filmimeve). "Do të jetë një sezon me shumë të papritura në fillim. Personalisht jam entuziast, pasi këtë vit do të ketë shumë të reja, të cilat ne mezi presim t'i zbulojmë. Kjo gjë vlen për të gjitha skuadrat, pasi rregullat e reja mund të sjellin surpriza në pistë. Ky është një projekt i jashtëzakonshëm, që kërkoi shumë punë", u shpreh Vettel, katër herë kampion bote në Formula 1. "E vështirë të thuash se çfarë pres nga kjo makinë dhe ky sezon, pasi ka shumë gjëra të reja. Ne synojmë të jemi sa më pranë makinave të kreut. Personalisht jam në formë. Jam përgatitur mirë dhe kam pushuar gjatë", ka deklaruar Vettel gjatë paraqitjes të njëvendësjes Aston Martin.

Reali në verë liron tre futbollistë

Pas disa vjetësh masa të caktuara shtrënguese, Real Madridi synon t'i japë skuadrës një përmirësim të madh gjatë afatit kalimtar të verës. "Los Blancos" duan të rekrutojnë një mesfushor qendror, të gjejë një zëvendësues për brazilianin Casemiro dhe, në veçanti, të inkorporojë një sulmues të ri të aftë për ta bërë dallimin për një periudhë të gjatë kohore, francezin Kylian Mbappe. Në mënyrë që të krijojë vend për shtesat e reja dhe t'i lirojë faturat e pagave, klubi tashmë ka vendosur që të lirojë tre lojtarë që do t'i mbarojnë kontratat e tyre verën e ardhshme. Marcelo, Isco dhe Gareth Bale janë pranë lamtumirës përfundimtare nga klubi madrilen.

Koulibaly konfirmon se nuk do të largohet nga Napoli

Mbrojtësi i Napolit, Kalidou Koulibaly, është rikthyer në Napoli pas triumfit të Kupës së Afrikës me Kombëtaren e Senegalit. Senegalezi ishte ndër më të mirët për arritjen e madhe të kombëtares së tij, që ndodhi për herë të parë në histori. Pas rikthimit në Napoli, Koulibaly i ka gëzuar tifozët duke u bërë me dije që nuk do të largohet. "Kjo mirëseardhje më gëzon shumë, por qetësohu se nuk po iki, nuk po iki. Jam kthyer në Napoli dhe jam i qetë. I falënderoj të gjithë, i kam parë të gjitha videot dhe gjërat që keni bërë kur unë nuk isha atje. Jam krenar që jam me ju. Ishte shumë bukur këtu dhe ishte shumë bukur në Senegal. Ju faleminderit të gjithëve!", ka thënë Koulibaly. Koulibaly pritet të jetë tani partner i Amir Rrahmanit në zemrën e mbrojtjes së "napolitanëve".



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 107 /1
Dt: 02.11.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

SHPLLJE E KONKURSIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendër e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë për vitin shkollor 2022/2023

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë	Prishtina	Një mësimdhënës/e për lëndë profesionale të makinerisë me 10 orë mësimore;	Vend i lirë
			Një mësimdhënës/e për lëndën e Edukatës Fizike me 10 orë mësimore.	Vend i lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe procese mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Procedurat e konkurrimit:**
 - Afati i konkurrimit është 15 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë.
 - Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
 - Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.
 - Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Albi Tel" SH.P.K. Zijadin Huskovci Maxwell France, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810172958, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Albi Tel" D.O.O. Zijadin Huskovci Maxwell France, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810172958, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Albi Tel" L.L.C. Zijadin Huskovci Maxwell France, has come to the decision to quit its business: 810172958, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM PËR SHUARJE TË BIZNESIT

Në bazë të Ligjit për shoqëritë tregtare Nr.06/L-016, nenit 112 dhe nenit 114 njoftojmë të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe palët tjera juridike dhe fizike se aksionari i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, German Tore - 2 Sh.p.k. me numër unik identifikues: 810849854 me seli në Prishtinë, Adresa: "Vëllezërit Fazliu" nr. 228 ka marrë vendim për shuarjen vullnetare të subjektit afarist dhe ka caktuar likuidatorin e paanshëm Erblin Hyseni me ID: 1240275038 me vendbanim në Rr. "Vëllezërit Fazliu" nr. 228, Komuna: Prishtinë me tel: 044/288-651 për zhvillimin e procedurës së Likuidimit.

Njoftohen të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe personat tjerë juridik dhe fizik që kanë interesa të përcaktuara dhe raporte kreditore-debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

SHPLLJE PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURËS SË LIKUIDIMIT

Në bazë të Ligjit për shoqëritë tregtare Nr.06/L-016, nenit 112 dhe nenit 114 njoftojmë të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe palët tjera juridike dhe fizike se aksionari i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Envision Sh.p.k. me numër unik identifikues: 810809618 me seli në Prishtinë, Adresa: Rifat Berisha H23/1 ka marrë vendim për shuarjen vullnetare të subjektit afarist dhe ka caktuar likuidatorin e paanshëm Gazmend Vërbovci me ID: 1171421795 me vendbanim në Ulpiana C-15-I Kati 2, Komuna: Prishtinë me tel: 045/707-070 për zhvillimin e procedurës së Likuidimit.

Njoftohen të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe personat tjerë juridik dhe fizik që kanë interesa të përcaktuara dhe raporte kreditore-debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

>> SHPLLJE TË VOGLA <<

► Afrim Krasniqi B.I. shpall të humbur certifikatën e biznesit me nr. 71346587 si dhe me nr. fis. 601724611.

► Sanije Hajrizaj-Gecaj, shpall të pavlefshme Licencën e Punës të Fiziatri të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, me dt. 27.12.2004, nr. KO-01197-01-14.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “ Ex Fis” Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Rahovec, Komuna e Rahovecit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 07.03.2022 në ora 10:00 në Zyrën e Kompanisë “ Ex Fis” Sh.p.k. Rruga e UÇK pn. në Rahovec , që gjendet në anën e djathtë të Magjistrale Rahovec-Xërxë ne kilometrin e dytë nga rreth rrotullimi i Rahovecit në drejtim të Xërxës do të organizohet debat publik nga Kompania “ Ex Fis” Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Rahovec, Komuna e Rahovecit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/7491688086?pwd=U05XRGMzcHpHRjI1OHhxdmNpUWJCUT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë “ Ex Fis” Sh.p.k. Prishtinë për stacionin e karburanteve në Rahovec, Komuna e Rahovecit.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publikimet/279/publikimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “ Ex Fis” Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Koretin, Komuna e Kamenicës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 08.03.2022 në ora 10:00 në restorant “KONAKU“ i cili ndodhet ne rrugën UÇK pn ne fshatin Koretin, në anën e majtë te rrugës Magjistrale Gjilan -Kamenicë do të organizohet debat publik nga Kompania “ Ex Fis” Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Koretin, Komuna e Kamenicës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/7491688086?pwd=U05XRGMzcHpHRjI1OHhxdmNpUWJCUT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë “ Ex Fis” Sh.p.k. Prishtinë për stacionin e karburanteve në Koretin, Komuna e Kamenicës.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publikimet/279/publikimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “ Ex Fis” Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në fshatin Qerim, Komuna e Gjakovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 07.03.2022 në ora 13:00 në Zyrën e Kompanisë “ Ex Fis” Sh.p.k. në fshatin Qerim e cila ndodhet në anën e majtë te rrugës Magjistrale Klinë –Gjakovë do të organizohet debat publik nga Kompania “ Ex Fis” Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në fshatin Qerim, Komuna e Gjakovës Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/7491688086?pwd=U05XRGMzcHpHRjI1OHhxdmNpUWJCUT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë “ Ex Fis” Sh.p.k. Prishtinë për stacionin e karburanteve në fshatin Qerim, Komuna e Gjakovës

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publikimet/279/publikimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbresa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

